



Pranimi / Dorezimi Prilazja / Prilazje Received / Delivery	28.09.2023	3	SH. Q. Nr. 117
Organ / Jedisica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIPMSHCK	6290/2023		117



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1080/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare Arben Mehmeti, dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën e ankuesit [REDACTED] me adresë rruga [REDACTED], kundër Vendimit me Nr1801 të datës 21.07.2023 të Komisionit Disiplinor ne Inspektoratin e Punës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 27.09.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1080/2023 e datës 14.08.2023, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED]

II. MBETET ne fuqi Vendimi me numër Nr.1801 i datës 21.07.2023, i Komisionit Disiplinor të Inspektorati i Punë.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [REDACTED] i punësuar sipas Akt Emërimit IP nr.57/2017 të datës 06.03.2017 në pozitën *Menaxher i IT*, më datë 28.03.2023 Drejtoresha e Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshëm si mbikëqyrëse e drejtpërdrejt e ankuesit, ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor.

Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës më datë 05.05.2023 ka nxjerr Vendimi me Nr.IP1138 përmes të cilit ankuesin e ka shpall përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore “ndalim i 40% i pagës për një periudhe deri në gjashtë muaj”.

Ankuesi kundër Vendimit me numër 1138 të datës 05.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, më datë 29.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4504/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 12.07.2023, ka marr vendim me të cilin ka obliguar Komisionin Disiplinor që të beje rishqyrtimin e lëndës për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit [REDACTED]

Komisioni Disiplinore në Inspektoratin e Punës pas pranimit të vendimit me numër A.Nr.792/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ka rishqyrtuar vendimin e datës 05.05.2023 dhe me datën 21.07.2023 ka nxjerr vendimin me numër 1801 lidhur me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim 40% i pagës për gjashtë (6) muaj.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin me numër 1801 të datës 21.07.2023 të Komisionit Disiplinor në Inspektoratin e Punës me datën 14.08.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5637/2023 me pretendim ankimor se vendimi në fjale ka aplikim të gabuar të drejtës materiale, vërtetim të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike si dhe shkelje të dispozitave të procedurës administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.08.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 29.08.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Raporte nga konsulta mjekësore të datës 13.05.2022; Certifikatën e datës 08.06.2022 lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin të Drejtat dhe Detyrat për Zyrtareve Publik dhe Kodi i Mirësjelljes; Emalin e datës 6.04.2022 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Ankesën e datës 14.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Procesverbalin e datës 04.05.2023 të Komisionit Disiplinore në Inspektoratin e Punës; Vendimin me numër A.nr.792/2023 të datës 12.07.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.08.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 29.08.2023; Vendimin me numër 1801 të datës 21.07.2023 të Komisionit Disiplinore në Inspektoratin e Punës; Ankesën me numër të protokollit 4504/2023 të datës 29.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Dokumentin mjekësor të datës 04.05.2022; Emalin e datës 07.05.2023 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED]; Procesverbalin e datës 05.05.2023 të Komisionit Disiplinore; Shkresën mjekësore të datës 01.02.2022; Shkresën mjekësore lidhur me rezultatin për virusin COVIT; Emalin e datës 03.03.2022 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Emalin e datës 26.04.2022 të [REDACTED] drejtuar [REDACTED] Certifikatën e datës 08.06.2022 lidhur me pjesëmarrjen e trajnimit " Të drejtat dhe Detyruat e Zyrtareve Publike dhe Kodi i Mirësjelljes"; Shkresën mjekësore të datës 13.05.2022; Raportin



mjekësore 04,05,2022; Vendimin për pushim mjekësore të datës 15.07.2022; Vendimin për pushim mjekësore të datës 08.11.2022; Emalin e datës 02.08.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 01..08.2022 të [redacted]; Emalin e datës 11.08.2022 të [redacted] drejtuar [redacted]; Emalin e datës 10.20.2022 të [redacted] drejtuar [redacted]; Emalin e datës [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 11.011.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 14.11.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 29.11.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 18.01.2022 të [redacted] drejtuar [redacted]; Emalin e datës 13.12.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 05.12.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 05.12.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 14.12.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 13.12.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 05.12.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 05.12.2022 të [redacted] drejtuar [redacted]; shkresën mjekësore të datës 04.05.2022; Shkresën mjekësore të datës 06.12.2022; Flete lëshimin e datës 21.12.2022 deri me datën 27.12.2022; Vendimin për pushim të datës 17.01.2023; Vendimin me numër të protokollit 1138 të datës 05.05.2023 të Komisionit Disiplinore; Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin të vendimit me numër 878/2020 të datës 14.10.2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 23.01.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 02.06.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 20.06.2023; Vendimin me numër 202/2022 të datës 19.07.2022 të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; Emalin e datës 17.01.2023 të [redacted] drejtuar [redacted]; Emalin e datës 17.01.2023 të [redacted] drejtuar [redacted]; Kërkesën për hapjen e procedurës disiplinore të datës 05.04.2023; Emalin e datës [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 27.03.2023 të [redacted] drejtuar [redacted]; Emalin e datës 27.03.2023 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 29.04.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 04.07.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 04.07.2022 të DMZP-së; Emalin e datës 15.07.2022 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 12.08.2022 [redacted] drejtuar [redacted]; Akt emërimit me numër të proktollit 57/2017 të datës 06.03.2017 për korigjonin e gabimeve të akt emërimit të [redacted] Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës të datës 13.01.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës të datës 04.01.2022; Vërejtjen me shkrim me numër të proktollit 1240 të datës 07.10.2021; Emalin e datës 02.05.2023 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 04.05.2023 të [redacted] drejtuar [redacted]; Evidenca e hyrje-dalje ne pune për datën 18-janar.2022; Evidenca për hyrje-dalje për datën 02.02.2022; Evidenca për hyrje- dalje në punë për datën 03.02.2022; Evidenca për hyrje dalje në punës për datën 04.02.2022; Evidenca për hyrje dalje në punës 07.02.2022; Evidenca për hyrje dalje në punës për datën 08.02.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 09.02.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 02.03.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 03.03.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 28.03.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 29.03.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 26.04.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 27.04.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 27.04.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 28.04.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 11.05.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 12.05.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 13.05.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 10.05.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 06.05.2022; Evidenca për hyrje dalje ne pune për datën 05.05.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 04.05.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 05.07.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 06..07.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën

07.07.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 08.07.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 14.07.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 15.07.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 27.07.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 18.08.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 17.08.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 16.08.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 15.08.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 11.08.2022; Evidenca për hyrje dalje në punë për datën 02.08.2022; Raportin për periudhën e filluar 01.06.2022 deri 31.12.2022 për prezence në punë; Emalin e datës 07.04.2022 të drejtuar Emalin e datës 29.04.2022 të drejtuar ; Emalin e datës 02.02.2022 të drejtuar Emalin e datës 02.04.2022 të drejtuar Emalin e datës 28.04.2022 të drejtuar ; Emalin e datës 13.07.2022 të drejtuar Emalin e datës 15.07.2022 të drejtuar Emalin e datës 15.08.2022 të drejtuar ; Emalin e datës 11.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 12.06.2022 të drejtuar Emalin e datës 12.08.2022 të drejtuar Emalin e datës 12.12.2022 të drejtuar Emalin e datës 27.12.2022 të drejtuar Emalin e datës 28.12.2022 të drejtuar Emalin e datës 17.01.2023 të drejtuar Emalin e datës 18.01.2023 të drejtuar Emalin e datës 18.01.2023 të drejtuar Emalin e datës 20.01.2023 të drejtuar Emalin e datës 13.01.2023 të drejtuar Emalin e datës 01.19.2023 të drejtuar Emalin e datës 18.01.2023 të drejtuar Emalin e datës 17.01.2023 të drejtuar Emalin e datës 17.01.2023 të drejtuar , Emalin e datës 18.01.2023 të drejtuar emalin e datës 18.01.2023 të drejtuar Emalin e datës 13.02.2023 të drejtuar ; Emalin e datës 13.02.2023 të drejtuar Emalin e datës 14.02.2023 të drejtuar Emalin e datës 14.02.2023 të drejtuar Emalin e datës 16./02.2023 të drejtuar Emalin e datës 16.02.2023 të drejtuar Emalin e datës 28.03.2023 të drejtuar ; Emalin e datës 27.03.2023 të drejtuar Emalin e datës 27.03.2023 të drejtuar Emalin e datës 27.03.2023 të drejtuar ; emalin e datës 27.03.2023 të drejtuar ; Emalin e datës 27.03.2023 të drejtuar Emalin e datës 27.03.2023 re drejtuar Emalin e datës 27.03.2023 të drejtuar emalin e datës 27.03.2023 të drejtuar Emalin e datës 27.03.2023 të drejtuar Emalin e datës 24.03.2023 të drejtuar Emalin e datës 15.03.2023 të drejtuar

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në këto rrethana, dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.1801 të datës 21.07.2023 të Komisionit Disiplinor për shqiptimin e masës disiplinore "Ndalim i 40% i pagës për gjashtë muaj", pretendon se me rastin e

inicimit të procedurës disiplinore Komisioni Disiplinore ka bere aplikim te gabuar te drejtës materiale, vërtetim te gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe shkelje të dispozitave të procedurës Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës me datë 21.7.2023 ka nxjerrë Vendim me numër të protokollit Nr.1801, sipas të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"Ndalim 40% e pagës për 6 (gjashtë) muaj"* në zbatim të Vendimit me numër A.nr.792/2023 te datës 12.07.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të Punës, përmes se cilit e ka detyruar Komisionin Disiplinor te Inspektoratit të Punës që ta rishqyrtoj procedurën disiplinore ndaj ankuesit.

Kolegji per shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar Vendimin me nr Nr.1801 të datës 21.7.2023, të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, ka konstatuar se: Komisioni disiplinor ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse me rastin e shqiptimit të masës disiplinore: *"Ndalim 40% e pagës për gjashtë (6) muaj"*, ka marrë për bazë të gjitha faktet dhe provat që kanë shpjer deri tek ky vendim.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të lëndës dhe fakteve të prezantuara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se: duke marrë parasysh se ankuesi edhe në të kaluarën respektivisht me date 07.10.2021 i është shqiptuar masa disiplinore *"vërejtje me shkrim"* nga udheheqesja e drejteperdrejte e tij per shkak te mungesave te vazhdushme dhe mungeses pa arsye ne pune, i njejt i nuk ka pasur asnje permisim lidhur me mungesen ne pune dhe i njejt i ka vazhduar edhe per vitin 2022 me sjelljet dhe mungesat e njejt i ku ne arsyeteimin e Vendimit me numer me numer 1801 te dates 21.07.2023 gjegjesisht sipas vleresimit te Komisionit Disiplinor ankuesi ka munguar gjithsej pesëdhjetë e katër ditë (54) dite, ndersa bazuar ne deshmit e ofruara dhe shkresat e lendes Kolegji ka gjetur se edhe përkundër se ankuesi per disa dite ka ofruar deshmi me të cilat i ka arsyetuar mungesat në pune i njejt i per gjithesjtë 30 ditë nuk ka ofruar as edhe një deshmi të vetme me të cilat do të arritinte ti arsyetoj mungesat në punë, prandaj masa disiplinore *"Ndalim 40% e pagës për gjashtë (6) muaj"*, e shqiptuar nga ana e Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, është masë e shqiptuar në proporcion me shkeljen e kryer nga ankuesi respektivisht në pajtim me nenin 45, paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L - 114, për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, në të cilin decidivisht thuhet se: *"1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit nuk ka mbështetje ligjore, rrjedhimisht ankuesi me vetëdije ka kryer shkeljen e theksuar, andaj veprimet e tij janë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil , respektivisht veprimet e tij paraqesin shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në të cilin thuhet se : *"46.Shkeljet disiplinore 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. ...3. Shkelje të rënda konsiderohen3.5. Braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e*

vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë". Po ashtu Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi me mungesat e vazhdueshme ne vendin e punës ka vepruar në kundërshtim edhe me dispozitat Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik cilat kanë qenë të aplikueshme deri më datë 12.10.2022, ku me nenin 8 të kësaj Rregullore është përcaktuar se: *"Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtaret publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik. 2. Mos respektimi i orarit të punës paraqet shkelje disiplinore. 3. Përgjegjës për vijueshmëri në punë të zyrtarëve publik është menaxheri drejtues. 4. Për çdo largim nga vendi i punës gjatë orarit, zyrtari publik duhet të marrë leje menaxheri drejtues, ndërsa nga data 12.10.2022 është në fuqi Rregullorja (QRK) Nr. 07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, e cila në nenin 9 paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5, ka përcaktuar se: "1. Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë prezent në vendin e punës. 2. Çdo zyrtar publik është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni. 3. Mosregjistrimi në librat e vijueshmërisë në punë apo në regjistrin elektronik, llogaritet si mosprezencë në punë. 4. Përgjegjës për vijueshmëri në punë të zyrtarëve publik, është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 5. Mos respektimi i orarit të punës, sipas Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik paraqet shkelje disiplinore"*.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, me rastin e parashtrimit të kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore, ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni Disiplinore në Inspektoratin e Punës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 1801 te datës 21.07.2023 në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen e bërë nga ankuesi, në këtë rast ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore si: ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit, po ashtu masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht, nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenin 48 paragrafi 2 dhe 3, nenin 50 paragrafi 1, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 11, nenin 12, nenin 13 paragrafi 1, 1.1, 1.2, paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 dhe 4.2 dhe paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, në këtë rast Komisionit Disiplinor në Inspektoratin e Punës përveç kësaj vendimin e ka nxjerr duke u bazuar në provat vendimtare që kanë të bëjnë më rastin konkret, dhe të njëjtin e ka arsyetuar në përputhje të potë me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet të ankuesit ndaj këtij vendimi janë pretendimet të pabazuara dhe të pa argumentuara me prova konkrete.*


Bazuar si më lartë, Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1080/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI


Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Udhëheqësit të burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.